
THE POLITICAL CRISIS IN NORTH MACEDONIA AND ITS IMPACT ON SECURITY AND STABILITY IN THE REGION

Hasan Asani

Faculty of Islamic Studies, Skopje, North Macedonia

Jonuz Abdullahi

South East European University, Skopje, North Macedonia, j.abdullahi@seeu.edu.mk

Abstract: This research paper will address the current situation in the country, analyzing the socio-political situation of recent years, the challenges that the state institutions are facing during the Euro-Atlantic integration process and in particular the problems after the visa liberalization process for citizens of North Macedonia.

As a result, we will present a causal scheme of society development in North Macedonia, as a state in which political crisis is present for a long time, a phenomenon that significantly undermines the functioning of the state institutions and affects the stability, peace and security in the country and the region.

Moreover, in this research we will describe the current crisis in Middle East states, which was one of the main generators for the regional security instability of the Balkans and Europe. On the other hand, the relations of North Macedonia with its neighbors, in particular with Greece and Serbia, during the crisis with refugees, and the reasons for the failure of state institutions for quality management of this ongoing crisis will be analyzed. An important place in this paper will also take the role and contribution of NGOs in overcoming the grave humanitarian situation faced by state institutions and refugees from regions involved in war.

To achieve the desired results in this paper we will use different scientific methods, such as analysis and processing of different texts, as well as analytical, statistical and comparative methods. We will also use secondary techniques such as questionnaires, conducted with citizens from the Polog region, which will be processed and will be part of this scientific research.

Keywords: security, refugee crisis, stability, the Balkans, North Macedonia

KRIZA POLITIKE NË MAQEDONINË E VERIUT DHE NDIKIMI I SAJ NË SIGURINË DHE STABILITETIN NË RAJON

Hasan Asani

Fakulteti i Shkencave Islame Shkup, hasan-hasani69@hotmail.com

Jonuz Abdullahi

UEJL, j.abdullahi@seeu.edu.mk

Abstrakti: Në këtë punim hulumtues shkencor do të trajtohet situata aktuale në vend, duke analizuar gjendjen socio-politike të viteve të fundit, sfidat me të cilat përballen institucionet shtetërore me procesin e integritetit euro-atlantik, e në veçanti me problemet pas liberalizimit të vizave për qytetarët e Maqedonisë së Veriut.

Si rrjedhojë do të paraqesim një shemë kauzale të zhvillimit të shoqërisë në Maqedoninë e Veriut, si një shtet në të cilin për një kohë të gjatë mbretëron krizë politike, dukuri e cila në mënyrë të konsiderueshme e cenon funksionimin e institucioneve shtetërore dhe ndikon në sigurinë, paqen dhe stabilitetin në vend dhe rajon.

Për më tepër në këtë hulumtim do të përshkruajmë krizën aktuale në shtetet e lindjes së mesme, e cila ishte një ndër gjeneratorët kryesor për destabilitetin rajonal të sigurisë së Ballkanit dhe Evropës. Nga ana tjetër, do të analizohet edhe raporti i Maqedonisë së Veriut me fqinjët, në veçanti me Greqinë dhe Serbinë, gjatë krizës me refugjatët, dhe shkaqet për dështimin e institucioneve shtetërore për menaxhim cilësor të kësaj krize në vazhdim. Gjithashtu, vend me rëndësi në këtë punim zë edhe roli dhe kontributi i OJQ-ve në tejkalimin e gjendjes së rëndë humanitare me të cilën ballafaqoheshin institucionet shtetërore dhe të ikurit nga rajonet e përfshira me luftë.

Për të arritur deri tek rezultatet e dëshiruara në këtë punim shkencor do të përdorim metoda të ndryshme shkencore, siç është analiza dhe përpunimi i teksteve të ndryshme, metodën analitike, statistikore dhe komparative. Gjithashtu do të përdorim teknikat ndihmëse të tilla si anketa – pyetësorë, të realizuara me qytetarë nga rajoni i Pollogut, të cilat do të përpunohen dhe do të jenë pjesë e hulumtimit shkencor.

Fjalët kyçe: siguria, kriza e refugjatëve, stabiliteti, Ballkani, Maqedonia e Veriut.

1. HYRJE

Rajoni i Ballkanit çdo here ka qenë qendër e politikave botërore si dhe ka paraqitur interes për fuqitë e mëdha botërore, mirëpo në vitet e fundit pothuajse të gjitha shtetet e Ballkanit perëndimor janë në mënyrë të vazhdueshme të kapluar nga kriza politike, të cilat rrezikojnë stabilitetin rajonal ekonomik dhe atë të sigurisë. Sipas Hejvudit, politika gjendet në zemër të gjithë aktiviteteve kolektive dhe shoqërore, zyrtare dhe jo zyrtare, publike dhe private, në gjitha grupet njerëzore, institucionet dhe shoqëritë. Për më tepër, ajo si veprimtari sociale dhe shoqërore gjendet në çdo pore të shoqërisë, nga familja si nukleus kryesor i shoqërisë dhe deri te grupet tjera shoqërore të cilat shtrihen në nivelin lokal dhe atë global botëror. Politika gjithashtu shihet edhe si art i qeverisjes me institucionet publike, duke u përpjekur të kuptoj se çka bëhet me shtetin si administrim dhe menaxhim i çështjeve publike. Gjithashtu politika si veprimtari sociale është e interesuar të kuptoj edhe rolin e aktorëve institucional në sferën publike, duke analizuar marrëdhëniet e strukturuar në bazë të pushtetit dhe ndikimin e tyre në sferën private. Politika si pjesë përbërëse dhe e pandashme e jetës kolektive, konsiston në njerëz dhe lëvizje shoqërore, që dalin përtej nevojave të tyre personale dhe interesave të ngushta ekzistenciale. Plotësimi i nevojave dhe detyrimeve të qytetarëve, si dhe krijimi i kushteve jetësore është në thelb vetë arsyeja e ekzistencës së veprimtarisë politike (Abdullai, 2016). Përmes këtij punimi kemi për qëllim të japim një qasje të ndryshme për problemet politike që e preokupojnë rajonin dhe Maqedoninë në veçanti, duke përfshirë krizën politike dhe impaktin e saj në sigurinë e vendit dhe rajonit. Shkaqet e paraqitjes së krizave politike mund të jenë të shumta, por si më të dalluara në rrafshin e rajonit të Ballkanit në përgjithësi dhe Maqedonisë së Veriut në veçanti janë këto:

- Lidhshipi i paaftë (joadekuat dhe joprofesional)
- Udhëheqja e pamoralshme
- Korrupsioni dhe krimi i organizuar
- Mungesa e shtetit ligjor
- Zhvlerësimi dhe mospërfillja e opinionin publik
- Kontrolli shtetëror mbi mediat
- Humbja e besimit tek institucionet shtetërore
- Mospërfillja e faktorit politik shqiptar në vendimmarrje
- Mungesa e dialogut politik, etj

Këto shkaqe si dhe problemet të cilat ato i sjellin duhet të trajtohen me seriozitetin më të madh dhe në një kohë të shkurtë. Sipas Henry Kisinxherit, problemet të cilat nuk mjekohen paraqesin “krizë në pritje”. Të marrim për shembull, kriza botërore financiare nuk ka lindur javën e kaluar po as muajin e kaluar. Ajo ka filluar me problemet të cilat një kohë të gjatë nuk janë zgjidhur. Problemet janë si hijet: Nëse ktheheni kah to dhe filloni t’i ndjekni, ato do të hikin nga ju. Ndërsa nëse ju hikin nga ato, ato do të ju ndjekin dhe më herët ose më vonë do të ju kapin. Me fjalë të tjera, nëse injorojmë problemet tona dhe nuk i zgjidhim ato shpejt, ato do të bëhen më të mëdha dhe në fund do të shëndrohen në kriza (Adizes, 2009). Së këndejmi Ballkani Perëndimor si rajon karakterizohet nga nivele të larta të papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë. (Idris & Strachan, 2017).

Në kontekstin tonë, lirisht mund të themi se Maqedonia e Veriut për një kohë të gjatë e ka injoruar ekzistencën e këtyre krizave, duke i lënë që ato të zmadhohen dhe të bëhen problematike për vendin dhe rajonin. Organizimi i shtetit është i ngjashëm me një automobil shumë të ndjeshëm. Pjesët e tij shumë lehtë disbalancohen, ndërsa atëherë punët fillojnë të shkojnë mbrapsht (Adizes, 2009). Për më tepër, në rast krize, më e keqja që mund të ndodh është mos të ndërmerret asgjë.

Edhe pse Maqedonia e Veriut pas pavarësisë dhe sjelljes së kushtetutës së parë në vitin 1991 në vazhdimësi ka pasur jo-stabilitet politik të manifestuar me zgjedhje të parakohshme dhe me qeveri jo të konsoliduar, sërish zgjedhjet e parakohshme parlamentare të organizuara më 11 Dhjetor 2016, e sollën vendin në buzë të konfliktit të brendshëm, gjendje kjo e cila më 27 Prill të vitit 2017, kulminoi me dhunë në parlamentin e Maqedonisë së Veriut e cila si epilog kishte disa politikan të lënduar. Kjo ndodhi mori përmasa ndërkombëtare dhe u karakterizua me një reagim të vonuar, konfuz dhe kontradiktor të forcave të sigurisë së Maqedonisë. Për më tepër, Maqedonia e Veriut ka organizuar nëntë zgjedhje parlamentare që nga krijimi i sistemit shumëpartiak, ndërsa sistemi zgjedhor u ndryshua katër herë. Zgjedhjet mbahen mesatarisht në interval kohor më pak se tre vjet, ndërsa legjislativi zgjedhor pëson ndryshime të rëndësishme në më pak se shtatë vjet. Gjatë kësaj periudhe, Maqedonia e Veriut ka kaluar nëpër disa kriza politike për shkak të shkeljeve serioze të të drejtave dhe lirive të njeriut, mungesës së konsensusit politik midis partive politike dhe paqëndrueshmërisë politike ndëretnike (Kmezić & Bieber, 2017).

Shteti i Maqedonisë së Veriut edhe në të kaluarën ka pasur kriza politike të cilat kanë përbërë kërcënim për sigurinë e vendit. Rajkovçevski në publikimin e tij si momente veçanërisht të rëndësishme, të cilat ndikojnë mbi gjendjen e sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut i veçon: shpërbërjen e RSFJ-së, krizën në Kosovë (1999), konfliktin e armatosur në Maqedoninë e Veriut (2001), ngjarjet në lidhje me integrimet euroatlantike, presionet e vazhdueshme dhe propaganda e fqinjëve me të cilat preken çështjet e brendshme të shtetit dhe çështjet që kanë të bëjnë me

realizimin e të drejtave të maqedonasve të cilët jetojnë në vendet fqinje (Rajkovçevski, 2010). Mirëpo këtu nuk ceket asgjë që ka të bëjë me marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoninë e Veriut, të cilat për një kohë të gjatë janë bërë pikë e dhimbshme për funksionimin normal të shtetit, ngase nuk i jepet rëndësi e veçantë kësaj çështje të ndjeshme, si dhe problemet që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të barabarta të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut nuk gjejnë zbatim praktik nga institucionet shtetërore. Kjo ve në shprehje edhe krizën e identitetit me të cilën përballen maqedonasit, e që nuk është e njëjtë edhe tek shqiptarët.

Por jo çdoherë duhet që krizën ta shohim si diçka tejet negative, ngase nga ajo mund të përmirësohen sistemet jo-funksionale, të vërehen dobësitë dhe të mënjanoen kërcënimet për të ardhmen. Sipas Ajnshtajnit, kriza mund të paraqet një bekim për individët ose popujt, ngase secila krizë sjell një përparim. Çështja qëndron në atë se çfarë pozicioni do të marrim dhe se si do t'i qasemi asaj, në mënyrë ajo të shërbejë për avancimin dhe zhvillimin e shoqërisë në tërësi. Duke pasur parasysh këtë, edhe kriza politike dhe dhuna e ndodhur në parlamentin e Maqedonisë së Veriut e pasqyroj politizimin e skajshëm e forcave të rendit, të cilat për shkak të direktivave partiake nuk intervenuan në kohë, lejuan protestuesit të hyjnë në godinën e parlamentit dhe nuk e penguan sulmin ndaj politikanëve opozitar.

Ajo çka është me rëndësi është që duhet të bëhet dallimi në mes të problemeve reale dhe të grumbulluara për një kohë më të gjatë me të cilat ballafaqohet Maqedonia e Veriut, siç janë dështimi në realizimin e detyrimeve nga Bashkimi Evropian në lidhje me integrimet euro-atlantike, mosnjohja e kishës ortodokse Maqedonase nga ana e Serbisë dhe së fundi mosnjohja e gjuhës dhe historisë nga ana e Bullgarisë.

Tranzicioni i stërzgatur nga viti 1990 e këndej dhe kthimi kah nacionalizmi, mos-realizimi i marrëveshjeve paraprake, kriza e refugjatëve dhe e migrantëve nga lindja e mesme, janë burimi i krizave të cilat e kanë kapluar shtetin. Politikanët në rajon nuk po ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve të hapura, përkundrazi, mjaft shpesh ata i drejtohen retorikës etno-nacionaliste për qëllime elektorale. (Čeperković & Gaub, 2018)

Për më tepër, në parimet e lirisë dhe sigurisë për Gjermaninë të përpunuar nga Fondacioni Konrad Adenauer, kërcënimet e reja ndaj sigurisë sonë lindin nga brenda: nga shteti i jonë kushtetues i lirë dhe demokratik, normat dhe vlerat që janë të kërcënuara, për shembull nga e majta dhe e djathta ekstreme, fundamentalistët të cilët kanë tendencë drejt dhunës, terrorizmit dhe krimit të organizuar (Grabowm, 2007).

Në vijë me këtë është edhe angazhimi në vazhdimësi i faktorit ndërkombëtar i cili tërë kohën është prezent për tejkalimin e krizës politike në Maqedoni. Ndërkombëtarët janë edhe garantues të implementimit të MKO-së. Së fundi ishte marrëveshja e Përzahinos (2 Qershor – 15 Korrik 2015) e cila u arrit me ndërmjetësimin e komisarit për zgjerim Johannes Han. Si rezultat i kësaj marrëveshje u krijua Prokuroria Speciale dhe qeveria teknike. Së dyti, janë deklaruar, të cilat ose inkurajojnë aktivitetet specifike dhe tendencat politike me qëllim pjesëmarrjen nënçështjen e ndërtimit dhe vendosjes së paqes, ose paralajmërimin dhe denoncimin e disa veprimeve dhe zhvillimeve (Gashi & Hidri, 2008). Në Maqedoni në vazhdimësi kemi interes të theksuar të komunitetit Evropian dhe atë Amerikan për zgjidhjen e problemeve dhe avancimin e proceseve për integrim euro-atlantik. Në fund, ishte angazhimi i përfaqësuesve diplomatik të Unionit Evropian dhe të SHBA-ve të cilët sollën deri tek zgjidhja e problemit me emrin në kontestin me Greqinë, problem ky i cili ishte kyç për pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Aleancën Veriatlantike. (BIRN, 2019)

Për kompletimin e punimit do të paraqesim edhe rezultatet nga anketa e zhvilluar në periudhën kohore prej 01.03.2019 – 16.03.2019 me studentët e Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë dhe Shkup. Numri total i të anketuarve është 720 student, nga të dy gjinitë dhe përbërje të përzier etnike (Shqiptar dhe Maqedon).

Në pyetjen se si janë marrëdhëniet e Maqedonisë së Veriut me fqinjët, numri më i madh i të anketuarve i cilëson ato si të tensionuara edhe atë me 42.50%n nga të cilët shumica ose 58.82% janë pjesëtarë të komunitetit maqedon.

Tabela.1 Si janë marrëdhëniet e Maqedonisë së Veriut me fqinjët?

	Shqiptar	Maqedon	Totali
Të këqia	1.98%	0.00%	1.67%
Të ftohta	33.66%	5.88%	29.17%
Të mira	25.74%	35.29%	26.67%
Të tensionuara	38.61%	58.82%	42.50%
Totali	100.00%	100.00%	100.00%

Në pyetjen se a mendoni se lidhshipi i Maqedonisë së Veriut ka vepruar drejtë me procesin e ndërrimit të emrit në këmbim të anëtarësimit në NATO dhe UE, kemi një rezultat pak si divergjent në mes të etniteteve të ndryshme. Nëse 81.19% të shqiptarëve janë shprehur se e vlerësojnë pozitivisht ndryshimin e emrit në këmbim të anëtarësimit në UE dhe NATO, vetëm 23.53% të maqedonasve e kanë përkrahur këtë veprim.

Tabela 2. A mendoni se lidhshipi i Maqedonisë së Veriut ka vepruar drejtë me procesin e ndryshimit të emrit në këmbim të anëtarësimit në NATO dhe UE?

	Shqiptar	Maqedon	Totali
Të integrohet me emrin ekzistues	11.88%	29.41%	14.17%
Jo	6.93%	47.06%	12.50%
Po	81.19%	23.53%	73.33%
Totali	100.00%	100.00%	100.00%

Në pyetjen se a mendoni se ka krizë politike në Maqedoni, Një shumicë dërmuese e të anketuarve të përgjithshëm e kanë pohuar këtë, madje tek shqiptarët ky numër është pak më i lart se tek maqedonasit.

Tabela 3. A mendoni se ka krizë politike në Maqedoninë e Veriut?

	Shqiptar	Maqedon	Totali
Jo	7.92%	29.41%	11.67%
Po	92.08%	70.59%	88.33%
Totali	100.00%	100.00%	100.00%

Për sa i përket pyetjes se a mendoni se procesi zgjedhor në Maqedoninë e Veriut është fer dhe demokratik, kemi pothuajse të njëjtin rezultat, mirëpo në këtë rast si mohim të kësaj teze, ngase 79.17% të të anketuarve janë shprehur se procesi zgjedhor në Maqedoninë e Veriut nuk është demokratik dhe se i njëjti në vazhdimësi manipulohet nga pushteti.

Table 4. A mendoni se procesi zgjedhor në Maqedoninë e Veriut është fer dhe demokratik?

	Shqiptar	Maqedon	Totali
Jo	82.18%	64.71%	79.17%
Po	17.82%	35.29%	20.83%
Totali	100.00%	100.00%	100.00%

Të dhënat nga përpunimi i anketës, si dhe materialet e prezantuara më lartë në formë të analizës, na japin me dije se në Maqedoninë e Veriut mbretëron krizë e thellë politike, ku institucionet qeverisëse janë të kapura dhe jo-funksionale. Për më tepër, kriza politike në shtet ka sjellë deri tek funksionimi jo i mirë i organeve të sigurisë, dhe kjo ndodh për shkak të ndërhyrjes politike në këto institucione dhe organe. Kjo do të thotë se ndërhyrja politike me

kuadro jo-profesionale e vë në dyshim cilësinë dhe efikasitetin e këtyre shërbimeve të cilat luajnë rol të rëndësishëm në ruajtjen e sigurisë dhe paqes në rajon, në kohë të krizave globale me të cilat ballafaqohet rajoni, duke pasur parasysh krizën në lindjen e mesme dhe fluksin e madh të refugjatëve të cilët frekuentojnë përmes Ballkanit.

Nga kjo përfundojmë se cilado qeveri e ardhshme e cila do të formohet në Maqedoninë e Veriut do të përballet me sfida të vështirë për konsolidimin e shtetit ligjor dhe demokratik. Kjo më pastaj do të mundësojë funksionim profesional dhe cilësor të organeve të sigurisë dhe institucioneve shtetërore, gjë e cila ka munguar dhe ka qenë një ndër shkaqet kryesore për paraqitjen e krizës politike dhe socio-ekonomike në shtet. Ndiheza e faktorit ndërkombëtar në këtë fushë është më se e nevojshme, për shkak të përvojës së tyre shumëvjeçare si dhe për shkak të ngritjes profesionale të kuadrove të cilët do të mund të mësojnë nga praktikat e mira dhe ato bashkëkohore.

2. KONKLUZA DHE REKOMANDIME

- Kriza në sistemet e qeverisjes është sinjal për paraqitjen e problemeve shtetërore të cilat më vonë reflektojnë në marrëdhëniet dhe pozitat ndërkombëtare
- Marrëveshjet për zgjidhjen e konflikteve kanë lënë hapësirë për pakënaqësi për shkak të mosimplementimit të tyre
- Vonesat në implementimin e marrëveshjeve motivojnë elementet ekstreme
- De-politizimi i forcave policore dhe aftësimi i tyre profesional do të risë sigurinë në vend dhe rajon
- Në rastin e Maqedonisë së Veriut, zgjedhjet e parakohshme të njëpasnjëshme nuk prodhojnë zgjidhje për problemet e shumta që ka vendi, si ato nacionale ashtu edhe ndërkombëtare.
- Parakusht për fillimin e zgjedhjes së krizës politike në Maqedoninë e Veriut janë organizimi i zgjedhjeve të lira dhe të drejta
- Demokratizimi institucional – bazë për ndërtimin e shoqërisë funksionale
- Inkuadrimi i shoqërisë civile në demokratizimin dhe kontrollin e institucioneve shtetërore.
- Media të lira, informimi i drejtë dhe objektiv i qytetarëve
- Raporti i Pribesë paraqet një udhërrëfyes të qartë se cilat janë prioritetet në të cilat do të duhet të fokusohet vendi. Ato janë reformat në gjyqësor, polici, administratën publike si dhe liria e mediave.

BIBLIOGRAFIA

- Abdullai, J. (2016). Politika dhe politikat publike. Tetovë: Arbëria Design.
- Adizes, I. (2009). How to Manage in Times of Crisis. Novi Sad: Asse.
- BIRN., (2019). Western Balkans Stability Monitor, Balkan Investigative Reporting Network
- Ceperković, M. & Gaub, F. (2018). Balkan Futures Three Scenarios For 2025, EU Institute for Security Studies
- Grabowm, K. (2007). Parimet e lirisë dhe sigurisë për Gjermaninë, materiale për edukim qytetar dhe bashkëpunim ndërkombëtar të fondacionit konrad adenauer. Berlin, Fondacioni Konrad Adenauer.
- Gashi, B., & Hidri, P. (2008). Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike. Prishtinë: Instituti për studime të sigurisë dhe integritimeve - Katana.
- Idris, I. & Strachan, A. (2017). Economic drivers of conflict in the Western Balkans, Knowledge, Evidence and Learning for Development
- Kmezić, M & Bieber, B. (2017). The Crisis of Democracy in the Western Balkans. An Anatomy of Stabilitocracy and the Limits of EU Democracy Promotion, Balkans in Europe Policy Advisory Group
- Omari, L. (2015). Gjeopolitika, Demokracia pjesëmarrëse, sfida e integritimit Evropian. Tiranë: Universiteti Marin Barleti.
- Rajkovçevski, R. (2010). Ndërtimi i politikës së sigurisë: rasti i Republikës së Maqedonisë. Shkup: Fondacioni Konrad Adenauer.